



Dr. Shefqet Krasniqi

Bota demokratike gjithmonë i është frikësuar kaosit dhe ka bërë të pamundurën për t'i shmangur çdo situatë kaotike. Pothuajse gjithmonë kaosi është përfytyruar të ndodhë nga fanatikët, ekstremistët e fundamentalistët që shtypi botëror, ai perëndimor në veçanti, ka tentuar gjithmonë t'i identifikojë me muslimanët.

Aktualisht e ashtunjohura si Lindje e Mesme po përjeton një kaos të vërtetë. Krahas tragjedisë njerëzore afro trevjeçare në Siri, ku bota demokratike vuri 'veshët në lesh', Egjipti po përjeton kaodin më të madh të periudhës së vet bashkëkohore. Shteti tashmë ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Mijëra civilë të vrarë e të plagosur, nga dora gjakatare e puçit ushtarak, e cila pamëshirshëm godet bijtë dhe bijat e Egjiptit, që kanë dalë tash e sa kohë gjithandej nëpër rrugë duke kërkuar kthimin e autoriteteve legjitime, të cilat i zgjodhën për herë të parë pas dekada shtypjeje nga regjimi diktatorial i Mubarakut.

Pak ditë më parë, gjersa në pushtet ishte presidenti i zgjedhur në mënyrë demokratike, Muhamed Mursi, mbretëronte një klimë krejtësisht tjetër. Njerëzve iu kishte kthyer shpresa për ditë të mira në Egjipt. Kishin filluar nisma të shumta që Egjipti njëmend të bëhej i pavarur. Gazetari i mirënjohur arab, Ahmed El-Mensur, në një artikull të publikuar kohë më parë, në mënyrë të thuktë përmend disa nga të arriturat e Mursit, ndonëse nuk qëndroi në pushtet më gjatë se një vit:

1. Mursi ia ktheu Egjiptit vetëmjaftueshmërinë me bukë për 70%.

2. Mursi filloi projektin e investimit në kanalin e Suezit, i cili do t'i rriste të hyrat nga 3 miliardë në 100 miliardë dollarë në vit.
3. Mursi hapi dy zona industriale të nivelit të lartë, një nën mbikëqyrjen e Katarit e tjetrën nën mbikëqyrjen e Turqisë.
4. Mursi hapi degën e kompanisë Samsung për prodhim, jo për tregti, e cila do të siguronte mundësi punësimi për egjiptianët.
5. Mursi është përkujdesur për prodhimin e I-Pad-ve vendorë egjiptian, me karakteristika të veçanta sipas nevojave egjiptiane.

Por, kjo dritare shprese për Egjiptin u mbyll shumë shpejt. Dhuna dhe kaosi kapluan tërë vendin. Po ta dëgjonim këtë lajm pa pasur pak njohuri për Egjiptin mendja do të na shkonte te 'fanatikët islamik', kështu jemi mësuar të dëgjojmë gjithherë nga mediet tona kur përmendet kaosi. Por ja që kësaj radhe gjendja është tërësisht ndryshe. Në fakt, ajo që popullit egjiptian ia përplasi dritaren e shpresës për fytyrë është ushtria. Pra, udhëheqësit ushtarak, që sipas të dhënave dhjetë apo dymbëdhjetë më kryesorët prej tyre së bashku arrijnë moshën 950 vjet, u munduan dhe po mundohen ta shuajnë shpresën për një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt të Egjiptit. E gjithë kjo në emër të demokracisë, dhe demokracia hesht.

Pa dyshim se grushtetin e përkrahen partitë politike laike nga brenda dhe e ndihmuan grupe të interesit të caktuar, përfshirë edhe qeveri, nga jashtë. Në këtë drejtim ndoshta kanë mundur të kontribuojnë edhe disa lëshime të Presidentit Mursi, i cili dorën në zemër nuk kishte shumë përvojë politike. Por ato 'lëshime' assesi nuk arsyetojnë ndërhyrjen me dhunë të ushtrisë për të përmbysur presidentin dhe qeverinë e zgjedhur nga vet populli.

Sa e sa herë janë etiketuar e qortuar muslimanët se forma e ndryshimeve nuk është përdorimi i forcës e lerë më dhunës, por ja tash kur kjo ndodh nga laikët apo sekularët bota hesht. Kulmi i dhunës 'demokratike' u arrit kur ushtria dhe policia po hapin zjarr ndaj protestuesve civilë e të pambrojtur duke i larguar ata nga sheshet e ndryshme. Të rinjtë e të rejat vriten e plagosen në emër të rendit dhe sigurisë. Egjipti është në prag të luftës civile, në prag të asaj që ka ndodhur më parë, me vite, në Liban e Irak dhe asaj që është duke ndodhur aktualisht në Siri. Si duket ata që nuk arritën ta ndalin pranverën arabe në ato vende tash po bëjnë çmos që ato vende t'i fusin në luftëra civile dhe kaos politik. Pranvera arabe, e cila veç patë filluar t'i japë frytet e saj, tashmë po rrezikohet për asgjësim. Akoma pa dalë mirë lulet e para të asaj pranvere të shumëpritur 'dashamirët e lirisë dhe demokracisë' ndërhyjnë për t'i shuar ato lule, duke e kthyer kështu këtë pranverë në një vjeshtë të tharë ku çdo gjë sinjalizon fundin.

Akoma më shqetësuese mbeten qëndrimet e organeve ndërkombëtare, të cilat janë mjaftuar me një mori murmuritje për keqardhje, apele për ndalje të dhunës madje 'nga të gjitha palët' gjersa nuk ndërmarrin asnjë veprim konkret. Madje një raport nga zyra e kryeministrit Erdogan potencon se qëndrimi i botës 'së civilizuar' ndaj grushtetit ushtarak nxiti ushtrinë e policinë egjiptiane të bëjnë masakra ndaj popullatës së vet, e i njëjti raport i bën thirrje urgjente faktorit ndërkombëtar të ndërhyjë për të ndalur dhunën në Egjipt.[1] Erdogan ishte më i zellshmi në kritikën e tij kundër përdorimit të dhunës nga forcat egjiptiane, por thirrjet e tij hasën në veshë të shurdhër të aleatëve ndërkombëtarë.

Vërtet e çuditshme dhe e neveritshme të shohësh tek tolerohen dhe përkrahen grushtet nga ushtria, të largohen njerëzit e zgjedhur nga populli, kryekomandantët e forcave ushtarake të burgosen nga 'ushtarët' e vet, e pastaj të shpartallohen protestuesit me tanke e helikopterë duke zbrazur breshëri automatikësh mbi turmat e civilëve duarthatë, të cilët vetëm shprehin pakënaqësinë e tyre, të vriten qindra mijëra gra e fëmijë, pleq e të rinj dhe prapë bota 'demokratike e paqedashëse' të qëndrojnë duarkryq! Kjo është vërtet e pa pranueshme. Por si duket demokracia bashkëkohore nuk është asgjë më tepër se interes. Ajo për dikë di të jetë 'nënë' e për dikë 'njerë'. Por Zoti është i Madh, Ai sheh dhe dëgjon. E siç thotë Allahu:

"Ne, këto ditë i ndërrojmë (u japim në përdorim) në mes njerëzve." (Ali Imran: 140)

Apo siç thekson fjala e urtë "Bota është e rrumbullakët (rrotë) dhe së bashku me kohën ajo sillet, herë përkrah e herë kundër teje".

Çka të themi tjetër pos siç ka thënë Ibrahim alejhi selam kur tërë bota u vu kundër tij:

"Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!" (Ali Imran: 173)

Edhe ne themi të njëjtën, popullit të Egjiptit dhe gjithë të tjerëve ju mjafton Allahu, Ai di më së miri të sjellë: buzëqeshje pas lotëve, siguri pas frikës, paqe e rehati pas luftërave e vuajtjeve dhe lehtësim pas vështirësive. Ndërsa ushtria egjiptiane dhe (pa)udhëheqësit politikë nuk do t'i shpëtojnë ndëshkimit pas kësaj masacre e gjenocidi ndaj popullit të vet. Ata nuk do të mund ta sfidojnë vullnetin e dhjetëra miliona egjiptianëve. Madje as dorëheqjet e tyre nuk do të bëjnë punë. Mallkimi i popullit do t'i ndjek edhe në varr e në amshim. Ndërsa populli egjiptian dhe ai musliman në përgjithësi nuk do t'ia harrojë botës 'së civilizuar' këtë 'favor' që po bën gjerë me tani karshi Egjiptit. Secili udhëheqës mund të bëhet i udhëhequr një ditë. O Zot bëjë hair çdo ndodhi në botë, vetëm Ti di t'i kthesh të këqijat në të mira dhe negativet në pozitive.